



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:281351

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05607437

C.nr.1497/2023

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.M, me vendbanim në V, Rruga "... M", të cilën e përfaqëson e autorizuar F.B, avokate me seli në V, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Arsimit me seli në Vushtri, të cilën e përfaqëson Ismet Gashi, me objekt kontesti kompensim për 70% të shpenzimeve të udhëtimit-rrugës, për ditët e pranisë në punë, me vlerë të objektit të kontestit 301.00 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të datës 11.04.2024, në të cilën ishin të pranishëm përfaqësuesja e paditëses dhe përfaqësuesi i të paditurës, ndërsa me datë 23.04.2024, përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.M dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditëses, në emër të kompensimit të 70% të shpenzimeve të udhëtimit-rrugës, për ditët e pranisë në punë për 270 ditë pune dhe atë për periudhën kohore nga data 13.12.2020 e deri me datë 21.11.2022, t'ia kompensoj shumën në vlerë prej 189.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë me datë 13.12.2023, e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. **REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses E.M, me të cilën ka kërkuar që ne emër të kompensimit të 70% të shpenzimeve të udhëtimit-rrugës për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore nga data 03.06.2020 e deri me datë 12.12.2020 përpos kompensimit për ditët e punës së aprovuar me dispozitivin I, të kompensohet edhe për 160 ditë pune, në shumën prej 112.00 euro.
- III. **DETYROHET** e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditëses E.M, në emër të shpenzimeve të procedurës, të ia paguaj shumën në vlerë prej 249.00 euro, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 13.12.2023, përmes përfaqësueses së tij të autorizuar, ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti për kompensim të 70% të shpenzimeve të udhëtimit-rrugës për ditët e pranisë në punë.

Prezantimet e palëve

Paditësja me padi ka kërkuar që gjykata ta detyroj të paditurën që duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit, (Tani e tutje KKA) t'ia paguaj asaj shpenzimet e udhëtimit-rrugës për ditët e pranisë në punë në shumën prej dy (2) euro në ditë për shkak të udhëtimit në relacionin Prishtinë-Vushtrri dhe anasjelltas dhe atë për 430 ditë pune në periudhën kohore nga data 03.06.2020 e deri me datë 21.11.2022, në shumën prej 602.00 euro, mirëpo në seancën përgatitore të mbajtur me datë 04.04.2024, e ka zvogëluar kërkesëpadinë duke e kërkuar shumën prej 301.00 euro, për shkak të shpenzimeve të udhëtimit në relacionin Vushtrri-Novolan dhe anasjelltas, me shpenzime ditore prej një (1) euro në ditë. Në fjalën përfundimtare e autorizuar e paditëses kërkoj nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses si dhe shpenzimet e procedurës 104.00 euro në emër të padisë, 21.00 euro në emër të taksës gjyqësore dhe 125 euro për seancën e datës 04.04.2024, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë me datë 13.12.2023, e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E paditura përmes përgjigjes në padi të datës 29.01.2024, e paditura ka kërkuar që gjykata ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të pabazuar me arsyetimin se të paditurës i mungon legjitimacioni pasiv për të qenë palë në këtë procedurë kontestimore sepse ajo nuk ka qenë pjesëmarrëse në marrëdhëniet detyrimore dhe nuk ka marrë obligime për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga KKA-ja por që këtë e kanë bërë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) të cilat nuk kanë përmbushur obligimet e kësaj Kontrate, për të siguruar mjete buxhetore për Komunitat, ndërkaq në seancën përgatitore përfaqësuesi i të paditurës ka theksuar se kërkesëpadia e paditëses për periudhën kohore nga data 03.06.2020 e deri me datë 13.12.2023, është e parashkuar.

Ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës ka theksuar që të njëjtat i bartë paditësja.

Provat

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka vlerësuar dhe administruar këto prova: Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Emin Duraku" në Novolan, nr.151, i datës 25.10.2023, Vërtetimi lëshuar nga Kombi-taxi i datës 05.04.2024, Vërtetimi i datës 05.04.2024 SHFMU "Emin Duraku" në Novolan dhe Certifikata e vendbanimit me nr. serik B10530990, e datës 18.03.2024.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadiës, provave të propozuara si dhe përgjigjes në padi në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje

çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë andaj e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësja kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura gjatë kësaj periudhës kohore për të cilën paditësja e ka kërkuar kompensimin. Po ashtu nuk ishin kontestuese as ditët e pranisë në punë nga paditësja të cilat janë aprovuar me dispozitivin I të këtij aktgjykimi, këto të vërtetuara edhe nga vërtetimi për ditët e punës, të cilave gjykata ia falë besimin e plotë duke u bazuar edhe në nenin 329.1, të LPK-së, në të cilin përcaktohet që *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, pasi janë lëshuar nga institucionet arsimore të së paditurës.

Kontestuese në mes palëve ishte fakti nëse pala e paditur ka legjitimitet pasiv në këtë çështje kontestimore dhe nëse kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar. Pra në këtë procedurë për gjykatën ishte e rëndësishme që ta vërtetoj bazën ligjore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses dhe besueshmërinë e saj me prova e po ashtu edhe pretendimet e palës së paditur se ajo nuk ka legjitimitet për të qenë palë në këtë procedurë dhe se kërkesëpadia e paditëses është parashkruar.

Me dispozitën e nenit 2.1.1 të KKA-së është përcaktuar që *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, kurse me pikën 1.2 të këtij neni të thuhet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*.

Sa i përket bazueshmërisë kërkesëpadiës së paditëses, e njëjta rrjedh nga neni 35.5 i KKA-së sipas të cilit përcaktohet se *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*, prandaj gjykata ka vendosur që ta aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi sepse i ka provuar ditët e punës dhe shpenzimet e udhëtimit gjatë periudhës kohore nga data 13.12.2020 e deri me datë 21.11.2022.

Konkretisht sipas Vërtetimit nr.217/3, i datës 05.04.2024, i lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët “Emin Duraku”, në Novolan-Vushtri, për ditët e punës së paditëses, ajo gjatë periudhës kohore nga data 13.12.2020 e deri me datë 21.11.2022, ka pasur 270 ditë të pranisë në punë, në të cilat ditë të punës, sipas Vërtetimit të udhëtimit i lëshuar nga Agjencioni i

transportit të udhëtimit “Kombi Taxi”, i datës 05.04.2024, në emër të paditëses, për shkak të udhëtimit në relacionin Vushtrri-Novolan dhe anasjelltas, e njëjta ka pasur shpenzime të udhëtimit prej një (1) euro në ditë, dhe rezulton se detyrimi i të paditurës për paditësen, në emër të kompensimit për udhëtim në punë është 189.00 euro, që është 70% i shpenzimeve totale të udhëtimit (270.00 euro) për këtë periudhë kohore (270.00 euro - 30% = 189.00 euro), ndërsa nga Certifikata e vendbanimit me nr. serik B10530990, e datës 18.03.2024, është vërtetuar se paditësja ka vendbanim në Vushtrri.

Detyrimi i të paditurës ndaj paditëses është e përcaktuar edhe me nenin 8.1 të Ligjit nr 04/l-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është përcaktuar që *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*, kurse me nenin 245 të LMD-së është paraparë që *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e që në këtë rast e paditura është e detyruar që të përmbushë një detyrim ndaj paditëses, ashtu siç është vendosur në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Në anën tjetër për gjykatën nuk mund të qëndroj pretendimi i të paditurës se pasi që ajo nuk ka qenë nënshkruese e Kontratës Kolektive, asaj i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje. Kjo ngase në radhë të parë e paditura është punëdhënësi i paditëses dhe të njëjtit janë në një raport kontraktual të marrëdhënies së punës e po ashtu faktit se KKA-ja është e lidhur në nivel vendi, me efekt të zbatueshëm në të gjithë Republikën e Kosovës. Lidhur me këtë, me nenin 90, par 2.1 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, është paraparë që *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në nivel të vendit”* dhe mbi këtë bazë kërkesëpadia e paditëses si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi është e bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit nr. nr.2056 dhe nr.105, të lidhura në mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në njërën anë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) në anën tjetër.

Kurse gjykata e ka marrë si të bazuar pretendimin e palës së paditur të dhënë në seancë përgatitore për parashkrimin e kërkesës për një pjesë të kërkesëpadiës, prandaj ka vendosur si në dispozitivin II, të këtij aktgjykimi me të cilin për shkak të parashkrimit të kërkesës, ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses me të cilën kanë kërkuar që përpos kompensimit që i është njohur me dispozitivin I, të kompensohet edhe për periudhën kohore nga data 03.06.2021 e deri me datë 12.12.2020, për 160 ditë pune, në shumën prej 112.00 euro.

Ky vendim si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi është marrë ngase sipas nenit 87 të Ligjit e Punës, është paraparë se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, kurse paditësja padinë për kompensimin e shpenzimeve të rrugës nga KKA-ja gjatë periudhës kohore nga data 03.06.2021 e deri me datë 12.12.2020, e ka paraqitur me datë 13.12.2023, pra për këto ditë të punës (160), padinë e kanë paraqitur pas afatit prej tri (3) vitesh nga dita kur i ka lindur e drejta për ta kërkuar kompensimin përmes procedurës gjyqësore dhe në këtë mënyrë kërkesat për kompensimin e udhëtimit për këto ditë të punës janë parashkuar.

Duhet theksuar se gjykata faktin se paditësja gjatë periudhës kohore nga data 03.06.2021 e deri me datë 12.12.2020, ka pasur 160 ditë të cilat janë parashkruar, e ka bazuar në Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Emin Duraku” në Novolan, nr.151, i datës 25.10.2023 për ditët e punës për paditësen, ku evidentohet se ajo gjatë periudhës kohore 03.06.2020 e deri më 21.11.2022, ka pasur 430 ditë pune, nga të cilat 160 ditë të punës janë parashkruar kurse për 270 ditë të tjera gjatë periudhës kohore nga data 13.12.2020 e deri më 21.11.2022, të përcaktuara me Vërtetimin nr.217/3, i datës 05.04.2024, të lëshuara nga shkolla e njëjtë për ditët e punës së paditëses, asaj i është njohur kompensimi me dispozitivin I, të këtij aktgjykimi.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 265/2020 i datës 02.12.2020 paditëses me dispozitivin I, të aktgjykimit i'a njohu edhe të drejtën në kamatë ligjore, në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 13.12.2023, si dita e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë e deri në pagesën definitive.

Lidhur me shpenzimet e procedurës si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 449 të LPK-së e po ashtu nenit 452.2, të LPK-së sipas të cilit përcaktohet që *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t'ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, ashtu e paditura duhet që paditëses të ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro, në emër të taksës gjyqësore në shumë prej 20.00 euro, si dhe për seancën e datës 04.04.2024 shumë prej 125 euro, në shumë të përgjithshme prej 249.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:281351, C.nr.1497/2023, me datë 23.04.2024**

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh, pas ditës së pranimit të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.